



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 22 Shkurt 2023

Nr: 67

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS NË MINISTRINË E TURIZMIT DHE
MJEDISIT, PËR RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E
QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 22 Shkurt 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim çështjen administrativ me:

SUBJEKT: Zj. Ledina Beqiraj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për raportimin e veprimtarive publike

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 23.1.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka marrë indicie për organizimin e 2 (dy) veprimtarive publike të kryera nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të cilat rezultojnë të paraportuara në ndërfaqen e dedikuar për këtë qëllim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Indicia është marrë nëpërmjet provave ku pretendohet si në vijim:

1. *"Ministrja e Kulturës Elva Margariti dhe ajo e Mjedisit dhe Turizmit, Mirela Kumbaro po bëjnë bilancin e vitit të kaluar, ndërsa prezantuan dhe pritshmëritë e tyre për këtë vit që sapo ka nisur."*

Link:<https://www.facebook.com/Mirela.Kumbaro.Furxhi/videos/572160637769164>

2. *"Qendra e re e kompostimit në Belsh do të përpunojë të gjithë mbetjet e gjelbërta duke shmangur hedhjen e tyre në pikën fundore. Ministrja e Turizmit dhe Mjedisit Mirela Kumbaro Furxhi tha se projekti i kompostimit do të shtrihet edhe në bashki të tjera me karakter bujqësor".*

Link:<https://www.facebook.com/photo?fbid=711488567031910&set=pcb.711489657031801>

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht çështjen, vlerësoi se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n" e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

- 1- Më datë 16.02.2023, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e parë, nëpërmjet adresës elektronike dhe më datë 17.2.2023, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit bën me dije se: *"Lidhur me kërkesën e informacionit për aktivitetin e zhvilluar me Ministren e Kulturës zj. Elva Margariti dhe Ministrin e Turizmit dhe Mjedisit, zj. Kumbaro, ju bëjmë me dije se takimi i Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, zj. Kumbaro, dhe Ministrit të Kulturës zj. Elva Margariti është zhvilluar më datë 18.1.2023, pra një ditë para përcjelljes së kredencialeve institucionit të MTM-së, si rrjedhojë publikimi i këtij aktiviteti ka qenë i pamundur për shkak të mungesës së kredencialeve për të aksesuar në faqen e KQZ-së."*

2- Më datë 16.2.2023, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e dytë, nëpërmjet adresës elektronike dhe më datë 17.2.2023, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit bën me dije se: *"Lidhur me kërkesën e informacionit mbi aktivitetin e zhvilluar me Tematikë "Inagurimin i stacioneve të kompostimit Belsh" Për arsye teknike ka patur vështirësi në marrjen e kredencialeve për të aksesuar në faqen e KQZ-së dhe si rrjedhojë, takimi i planifikuar lidhur me inagurimin e stacioneve të kompostimit Belsh dhe Roskovec, i zhvilluar më datë 20.1.2023, ora 10:30, është përcjellë në e-mailin e datës 17.1.2023 në të cilin kemi bërë me dije mbi mungesën e kredencialeve dhe në mungesë të të dhënave për të aksesuar në faqen e internetit të KQZ-së, kemi njoftuar edhe mbi zhvillimin e këtij aktiviteti".*

Pasi u njoha me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerësoj se problematikat me sistemin dhe kredencialet kanë ardhur për shkak të vështirësive në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve dhe për shkaqe të tjera objektive jashtë vullnetit të organit publik.

Në këto kushte, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, vlerësoj se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të kryhet pushimi i hetimit administrativ për ato shkelje që lidhen me këtë arsyetim, deri në këtë periudhë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S :

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj zj. Ledina Beqiraj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.
2. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
3. Tërheqje vëmendje ndaj Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për marrjen e masave të menjëhershme, për raportimin e veprimtarive publike.
4. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI